



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL  
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË



**Thirrje për bursa studimi për studentët në kuadër të Programit Erasmus + për komponentin KA1 *International Credit Mobility* në Universitetin Transilvania në Brasov të Rumanisë**

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" në bashkëpunim me Universitetin e Transilvanisë në Brasov (Transilvania University of Brasov) në Rumani në kuadër të Programit Erasmus+ për komponentin KA1, fton gjithë studentët e UV-së të aplikojnë për të përfituar një bursë studimi/ për një periudhë prej **3 dhe 4 muajsh** në Universitetin e Transilvanisë në Brasov në Rumani. Në përfundim të mobilitetit studentët do të vijojnë studimet në universitetin e tyre të origjinës (UV). Ata nuk do të paguajnë asnjë tarifë shkollimi në universitetin pritës (Transilvania University of Brasov), por do të vazhdojnë të paguajnë tarifën që aplikohen në universitetin e tyre të origjinës (UV).

**Numri i bursave të studimit:** - 1 (një) për studime  
- 1 (një) për praktikë mësimore

**Periudha e mobilitetit:** - 4 muaj dhe 2 ditë për mobilitet studimi  
- 3 muaj dhe 2 ditë për mobilitet praktikë mësimore

**Bursa përfshin:**

- Kompensimin mujor: **800 EUR/muaj**
- Shpenzimet e udhëtimit: **275 EUR**, vlerë e përcaktuar në bazë të largësisë midis universitetit pritës dhe atij të origjinës. Përlllogaritja e largësisë bëhet në lidhjen e mëposhtme:  
[http://ec.europa.eu/programm.../erasmus-plus/.../distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programm.../erasmus-plus/.../distance_en.htm)

**Kriteret për aplikantët:**

- të jetë student: - Vitit të dytë dhe të tretë në programin Bachelor  
- Programin Master
- të jetë student i programit të studimit: - Gjuhë e huaj, për mobilitetin e studimit  
- Inxhinieri Navale, Inxhinieri Mekanike, Inxhinieri Elektrike për mobilitetin e praktikës mësimore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL  
SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

- të zotërojë njohuri të mira të gjuhës angleze ose të gjuhës që zhvillohet programi në universitetin pritës.

*Kriteret e përzgjedhjes: (sipas rëndësisë)*

- Merita akademike
- Preferencë do tu jepet studentëve që u përkasin grupeve vulnerabël.
- Prioritet më i ulët do t'u jepet atyre që kanë marrë pjesë më parë në mobilitete në të njëjtin cikël studimi.
- Barazia gjinore (aty ku është e mundur të përzgjidhen kandidatë të barabartë në numër për nga gjinia).

*Dokumentet e nevojshme për aplikim:*

- Formular aplikimi
- Kopje të pasaportës
- Vërtetim studentit
- Listë notash
- Letër motivimi
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohjen e gjuhës Angleze niveli B2

Më shumë informacion rreth universitetit Transilvanisë në Brasov do të gjeni në:  
<https://www.unitbv.ro/en/>

Dokumentat e aplikimit duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë brenda datës **16/11/2018** ora **16:00**.

Kandidatët fitues do të njoftohen prej Sektorit të Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë brenda dates **23/11/2018** ora **16:00** në adresën e tyre të e-mailit.

Për përzgjedhjen e studentëve ngrihet një komision i cili vlerëson studentët.

Universiteti do të pajisë të gjithë studentët e përzgjedhur me një kopje të **Erasmus+ Student Charter**

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus2/files/erasmus-student-charter-july2018\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus2/files/erasmus-student-charter-july2018_en.pdf)

Përpara fillimit të mobilitetit kandidatët fitues plotësojnë një *Learning Agreement* (Marrëveshje që vendoset midis studentit që aplikon dhe universitetit të origjinës, në të cilën paracaktohen kurset me kreditet përkatëse që studenti do të ndjekë gjatë semestrit në universitetin pritës, të cilat do t'i njihen në përfundim të tij dhe në vijim të studimeve në universitetin e origjinës).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE ZHVILLIMIT INSTITUCIONAL**  
**SEKTORI I PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Për më shumë informacion rreth skemës së mobilitetit dhe mënyrës së aplikimit, kontaktoni me Prof. As. Bledar Toska: [bledar.toska@univlora.edu.al](mailto:bledar.toska@univlora.edu.al) ose Prof. As. Kristofor Lapa: [kristofor.lapa@univlora.edu.al](mailto:kristofor.lapa@univlora.edu.al) ose me Sektorin e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë: [international@univlora.edu.al](mailto:international@univlora.edu.al) , pranë Rektoratit, Kati i I.

**SUKSESE!**